



RAPORTI MUJOR

JANAR
2025

Metodologjia

Iniciativa e Re Sociale (NSI) po kryen monitorimin e mediave online dhe mediave sociale në bashkëpunim me Pikasa Analytics INC, një kompani e analitikës së të dhënave e specializuar në zhvillimin dhe zbatimin e mjeteve, softuerëve dhe algoritmeve të mësimin të makinerive. Mjeti ua mundëson monitoruesve të numërojnë numrin nominal të artikujve për tema të caktuara dhe të shohin nivelin e angazhimit të audiencës.

Angazhimet në uebsajte përcaktohen si artikuj të lajmeve që janë shpërndarë në Facebook nga uebsajti i çdo burimi dhe numri total i pëlqimeve, shpërndarjeve dhe komenteve që janë grumbulluar. Angazhimet në mediat sociale përfshijnë pëlqimet, shpërndarjet dhe komentet e mbledhura nga të gjitha kanalet e mediave sociale (Facebook, Instagram, YouTube, TikTok, LinkedIn) për të gjitha postimet, duke përfshirë fotot, videot dhe tekstin. Vlerësimi i angazhimit shtrihet përtej organeve të mediave për të përfshirë një sërë llogarish të mediave sociale përfshirë ato të politikanëve dhe opinionbërësve.

Mjeti grumbullon artikuj dhe ekipi monitorues i NSI-së i shqyrton ato për të identifikuar dezinformimin e mundshëm dhe çrregullimet tjera informative. Sidoqoftë, mjeti ka disa kufizime. Është i përshtatur, me monitorë Pikasa dhe NSI të zgjedhur me kujdes për çdo llogari të vëzhguar. Rrjedhimisht, numri i përgjithshëm i postimeve dhe artikujve përfshin vetëm llogaritë e vëzhguara, duke përjashtuar llogaritë e tjera që gjithashtu mund të postojnë lajme. Llogaritja e angazhimit përbëhet nga të gjitha aksionet, komentet dhe ndërveprimet e tjera.

Për më tepër, llogaritë private mund të vëzhgohen vetëm nëse përcaktohen zyrtarisht si llogari të liderëve politikë ose faqe fansash. Për rrjedhojë, disa llogari të politikanëve në Facebook mund të mos përfshihen në analizë. Një kufizim tjetër lidhet me qasjen, pasi NSI mund të vëzhgojë artikuj dhe postime të publikuara që në 1 dhjetor 2023

Mediat e vëzhguara që raportojnë nga Kosova në gjuhën serbe:

Alternativna, Gračanica Online, Radio Kontakt Plus, Kosovo Online, KoSSev, Medija Centar, TV Most, Radio Kim, Radio Mitrovica Sever, Radio Televizioni Gračanica, dhe RTK2

Periudha e vëzhgimit:

1 - 31. janar 2025

Numri i mediave online të vëzhguara:

126 duke raportuar në shqip dhe serbisht në Kosovë, 126 nga Serbia dhe 24 media ndërkombëtare.

Qëllimi i monitorimit:

Çrregullimet informative në internet dhe media sociale, duke përfshirë uebsajtet, portalet e lajmeve online, Facebook, YouTube, TikTok dhe Instagram në Kosovë me fokus në hapësirën informative të serbëve të Kosovës.

Temat specifike të vëzhguara:

Mbyllja e institucioneve të drejtuara nga Serbia në Kosovë dhe aktivitetet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me zgjedhjet e 9 shkurtit

Key findings

- Narrativat etnike vazhdojnë të formësojnë mbulimin mediatik, ku mediat në gjuhën serbe dhe shqipe që paraqesin tregime kontradiktore të ngjarjeve kryesore.
- Akterët politikë dhe institucionet luajnë një rol qendror në promovimin e retorikës përçarëse, veçanërisht në diskutimet mbi institucionet e drejtuara nga Serbia dhe proceset zgjedhore.
- Mbyllja e institucioneve të drejtuara nga Serbia u paraqit ndryshe në mediat etnike, ku mediat në gjuhën shqipe theksuan sovranitetin dhe ligjshmërinë, ndërsa mediat në gjuhën serbe e portretizuan atë si përndjekje.
- Raportimi senzacionalist dhe shtrembërues mbi akuzat për korrupsion dhe financimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës kontribuoi në çrregullimin informativ.
- Termat nxitës që shënjestrojnë komunitetin shqiptar vazhdojnë të përdoren në mediat nga Serbia, duke minuar përpjekjet për dialog konstruktiv.


Rezultatet e monitorimit

Gjatë periudhës raportuese, media më aktive që raporton në gjuhën serbe ishte Kosova Online, e cila ka publikuar 2643 artikuj me 35,167 angazhime. E njëjta faqe ka regjistruar edhe më së shumti angazhime në rrjetet sociale.

Gjatë periudhës së raportimit, mediat në gjuhën serbe në Kosovë raportuan më së shumti për proceset gjyqësore për krime të luftës kundër një serbi të arrestuar (23 artikuj), ankesat zgjedhore të partive politike serbe në KQZ (20 artikuj), mbylljen e një dege të sigurimeve të drejtuar nga Serbia në Mitrovicën e Veriut (15 artikuj), përvjetorin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit (14 artikuj), dorëheqjen e kryeministres së Serbisë (14 artikuj).

Megjithatë, këto tema nuk gjeneruan shumë ndërveprime me audiencën në Facebook. Në vend të tyre, festat fetare dhe protestat në Serbi tërhoqën më shumë vëmendje në mbulimin mediatik në gjuhën serbe në Kosovë.

Artikujt e popullarizuar në gjuhën serbe në Facebook



Nuk pati mbivendosje direkte në temat më të raportuara mes mediave në gjuhën serbe dhe shqipe në Kosovë. Të dy gjuhët mbuluan gjerësisht mbylljen e institucioneve të drejtuara nga Serbia, por mediat në gjuhën serbe u përqendruan në mbylljen që kishte ndodhur më 8 janar, ndërsa mediat shqipe mbuluan atë të datës 15 janar. Në lidhje me mbulimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe zgjedhjeve të 9 shkurtit, mediat në gjuhën serbe theksuan ankesat e partive politike serbe, ndërsa mediat në gjuhën shqipe u përqendruan në aspektet teknike të zgjedhjeve dhe akuzat e drejtuara ndaj veprimeve të KQZ-së në lidhje me certifikimin e Listës Srpska.

Tema më e raportuar në mediat në gjuhën shqipe në Kosovë në janar, me 368 artikuj, ishte mbyllja e institucioneve të mbështetura nga Serbia.

Më 8 janar, policia e Kosovës filloi mbylljen e institucioneve të drejtuara nga Serbia, duke filluar me zyrën e Administratës Tatimore në Mitrovicën e Veriut dhe degën e kompanisë së sigurimeve në të njëjtin qytet. Më 15 janar, pas një vale mbylljesh në veri të Kosovës, operacioni u zhvendos në jug të lumit Ibër. Dhjetë organet e mbetura të përkohshme komunale dhe Shërbimi Postar i Serbisë në komunat jugore u mbyllën. Prokuroria e Kosovës ka sqaruar se policia nuk ka qenë e autorizuar për të kryer kontrolle dhe bastisje në këto lokacione. Vendet e Quintit e dënuan veprimin.

Mediat kanë raportuar për deklaratat e ministrave të Kosovës, Xhelal Sveçla dhe Elbert Krasniqi, në lidhje me mbylljen e institucioneve të drejtuara nga serbët në Kosovë.¹ Sveçla i cilësoi këto institucione si “struktura paralele kriminale”, duke theksuar se mbyllja e komunave serbe dhe “zyrave të paligjshme postare dhe tatimore” shënon fundin e qeverisjes paralele të Serbisë në Kosovë. Krasniqi po ashtu tha se diskutimi nuk duhet të jetë se pse po mbyllen këto institucione, por pse u lejuan të funksionojnë kaq gjatë, duke i cilësuar ato si jolegjitime dhe të dëmshme për sovranitetin e Kosovës.

Përderisa këto deklarata pasqyrojnë qëndrimin zyrtar të qeverisë së Kosovës, ato ngrenë shqetësime të mundshme lidhur me integritetin e informacionit. Termi “kriminale” paraqet një thjeshtim të tepërt të një çështjeje komplekse, pasi mungojnë provat e qarta dhe të vërtetuara që i lidhin këto institucione me aktivitetin kriminal.

Për më tepër, përdorimi i përsëritur i termave si “ilegale” dhe “kriminale” mund të shtrembërojë perceptimin publik, pasi ato mund të nënkuptojnë një natyrë tërësisht të paligjshme për këto institucione pa ofruar një pasqyrë të balancuar të rolit të tyre në historinë e rajonit.

Ministrja e Drejtësisë së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka reaguar ashpër ndaj deklaratës së Prokurorisë Themelore, e cila pretendon se operacioni policor është kryer pa autorizimin e tyre. Haxhiu e cilësoi deklaratën e prokurorisë si “skandaloze” dhe i kritikoi për dështimin e mbylljes së zyrave të strukturave ilegale vite më parë. Ajo gjithashtu vuri në pikëpyetje besnikërinë e prokurorëve duke pyetur “Kujt po i shërbejnë këta zyrtarë shtetërorë?”²

Përdorimi i gjuhës së ngarkuar nga Haxhiu, si fjala “skandaloze” dhe vënia në dyshim e besnikërisë së prokurorëve, pa ofruar prova ose kontekst të qartë, rrezikon të krijojë një narrativë të polarizuar. Ky qasje mund të nxisë mosbesimin e publikut ndaj prokurorisë dhe ta vërë padrejtësisht në shënjestër këtë institucion.

Me 366 artikuj, tema e dytë më e mbuluar në mediat shqipfolëse ishte veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me zgjedhjet e 9 shkurtit, duke përfshirë shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim.

Pas përpjekjeve të pasuksesshme të anëtarëve të Vetëvendosjes në KQZ për të ndaluar pjesëmarrjen e partisë më të madhe politike të serbëve të Kosovës, Listës Srpska, në zgjedhjet e 9 shkurtit, anëtari i LVV-së dhe Zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu, akuzoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se “përsëri ka shkelur ligjin duke e përfshirë Listën Srpska në fletëvotim”.

¹ <https://teve1.info/svecla-perfundon-epoka-e-komunave-dhe-institucioneve-paralele-e-kriminale-te-serbise-ne-kosove/> dhe <https://kosovapost.net/mbyllja-e-institucioneve-paralele-krasnigj-pse-jane-mbyllur-por-pse-kane-gene-ta-hapura-deri-sot/> dhe <https://www.zeri.info/aktuale/563020/mbyllja-e-institucioneve-paralele-krasnigj-pse-jane-mbyllur-por-pse-kane-gene-ta-hapura-deri-sot/> dhe <https://kosovapost.net/mbyllja-e-institucioneve-paralele-krasnigj-pse-jane-mbyllur-por-pse-kane-gene-ta-hapura-deri-sot/> dhe <https://rtv21.tv/krasnigj-sdo-duhej-te-diskutohej-pse-jane-mbyllur-strukturat-paralele-sot-por-si-kane-gene-ta-hapura-deri-sot/> dhe <https://www.arbresh.info/lajmet/krasnigj-sdo-duhej-diskutim-pse-jane-mbyllur-institucionet-e-serbise-por-pse-kane-ekzistuar/> dhe https://www.svri.net/svri_kosova/lajme/568403/krasnigj-reagon-pas-kritikave-te-be-se-diskutimi-nuk-do-te-duhej-te-behej-pse-jane-mbyllur-por-si-kane-gene-ta-hapura-deri-sot/


² <https://reporteri.net/lajme/komunikata-e-prokuroris-e-sotem-haxhiu-skandaloze-ne-sherbim-te-kujt-jane-keta-prokurore/> dhe <https://ballkani.info/mbyllja-e-strukturave-paralele-haxhiu-sulmon-prokurorine-ne-sherbim-te-kujt-jane/> dhe <https://www.periskopi.com/haxhiu-sulmon-prokurorine-pasi-treguan-se-skane-autorizuar-policine-per-mbylljen-e-institucioneve-serbe-deklarat-e-skandaloze-ne-sherbim-te-kujt-jane-keta-prokurore/> dhe <https://www.arbresh.info/lajmet/haxhiu-per-deklaraten-e-prokuroris-lidhur-me-institucionet-paralele-skandaloze-ne-sherbim-te-kujt-jane-keta-prokurore/> dhe <https://albanianpost.com/haxhiu-prokuroria-ka-bere-deklarate-skandaloze-per-strukturat-paralele/>

Sallahu pohoi se Vetëvendosje kishte dorëzuar një ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) lidhur me certifikimin e Listës Srpska dhe se, sipas nenit 130 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, KQZ duhej të pezullonte vendimin e saj deri në shqyrtimin përfundimtar nga PZAP. Ai argumentoi se, duke vazhduar me caktimin e një numri në fletëvotim për Listën Srpska para vendimit përfundimtar të PZAP-it, KQZ kishte vepruar në mënyrë të paligjshme.³

Certifikimi i Listës Srpska nga ana e KQZ-së, pavarësisht ankesës në pritje, është në përputhje me ligjet zgjedhore të Kosovës. Ligji nuk parashikon pezullim automatik të vendimit të KQZ-së me paraqitjen e ankesës në PZAP. Rrjedhimisht, akuza se KQZ ka shkelur ligjin në këtë rast rezulton të jetë një keqinterpretim i procedurave ligjore. Temat që u trajtuan më së shumti nuk fituan angazhimin më të madh të audiencës.

Gjatë periudhës raportuese, media më aktive që raportoi në gjuhën shqipe nga Kosova ishte Bota Sot, e cila ka publikuar 9,881 artikuj me 45,281 angazhime. Megjithatë, faqja që ka shënuar më së shumti angazhime në rrjetet sociale ishte Klan Kosova, me 206,963 angazhime, me 6,124 artikuj të publikuar në janar.

Artikujt e popullarizuar në gjuhën shqipe në Facebook



Megjithatë, dy nga artikujt më tërheqës në Facebook⁴ kishin përmbajtje potencialisht të njëanshme dhe pretendime të paverifikuara.

³ <https://nacionale.com/politike/blerim-sallahu-e-akuzon-kqz-ne-per-shkelje-te-ligjit-ia-ndau-numrin-listes-serbe-edhe-pse-u-ankuam> dhe <https://demokracia.com/sallahu-vazhdon-te-duket-gesharak-sulmon-krjetarin-e-kqz-se-pas-certifikimit-te-listes-serbe/> dhe <https://ajmi.net/sallahu-per-krjetarin-e-kqz-se-pas-certifikimit-te-listes-serbe-ka-deniguar-imazhin-dhe-nunen-e-pzap-se/> dhe <https://www.periskopi.com/zv-ministri-i-drejtise-nuk-i-ndal-sulmet-tash-merret-direkt-me-krjetarin-e-kqz-se/>

⁴ <https://paparaci.com/476357/keshilltari-i-kurtit-i-perfshire-ne-aferen-37-milioneshe-korruprive-te-kek-ut/> dhe <https://nacionale.com/politike/edhe-nje-afere-bombastike-shperthen-ne-kabinetin-e-kurtit-praq-energjia>

Artikulli pretendon se Fisnik Korenica, këshilltar i jashtëm i kryeministrit Albin Kurti për dialogun Kosovë-Serbi, është përmendur në një dosje të Prokurorisë Speciale lidhur me një skandal korrupsioni prej 37 milionë eurosh në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Sipas artikullit, Korenica ka qenë më parë aksionar me 50% në një kompani energjetike, e cila më pas është transferuar plotësisht te Bardhyl Hasanpapaj, një bashkëpunëtor i pretenduar i Presidentes Vjosa Osmani. Gjithashtu, artikulli thekson se ish-drejtori i KEK-ut, Nagip Krasniqi, i cili tani është i akuzuar për korrupsion, ka përmendur Korenicën si një nga ata që kishte rekomanduar angazhimin e një firme të caktuar ligjore për KEK.

Ndërsa artikulli bën akuza serioze, ai nuk ofron verifikim të pavarur nga burime të tjera. Pretendimet mbështeten shumë në lidhje indirekte dhe deklarata nga një zyrtar i paditur, duke ngritur shqetësime për paragjykime të mundshme ose informacion jo të plotë.

Një tjetër temë që shpesh mbivendoset në hapësirën informative serbe dhe shqiptare është raportimi për Dhomat e Specializuara të Kosovës. Artikuj nga portale të shumta⁵ në Kosovë raportuan për sfidat e mundshme financiare me të cilat përballen Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë pas një ngrirjeje të raportuar të financimit nga SHBA-të, që ka rezultuar nga një urdhër ekzekutiv i Presidentit Donald Trump.

Ky artikull përmban elemente të çrregullimit informativ, kryesisht për shkak të pasaktësive faktike dhe mungesës së burimeve të verifikueshme. Titulli dhe artikulli janë shtrembërues sepse paraqesin një pretendim të paverifikuar si fakt, duke thënë se SHBA ka ndërprerë financimin për Dhomat e Specializuara të Kosovës pa përmendur ndonjë burim zyrtar. Artikulli bazohet në raporte jozyrtare, të cilat nuk i atribuohen institucioneve të besueshme, duke e bërë pretendimin të paverifikueshëm. Për më tepër, formulimi i bujshëm i titullit nënkupton pasoja të menjëhershme dhe të rënda, edhe pse nuk ka asnjë provë konkrete për ta mbështetur këtë.

Kur bëhet fjalë për raportimin e mediave nga Kosova në gjuhën serbe, gjatë muajit janar, deklaratat e zyrtarëve serbë për mbylljen e institucioneve të Serbisë kontribuan në paraqitjen e perspektivës së njëanshme lidhur me këtë çështje.⁶ Deklaratat fokusohen vetëm në perspektivën serbe, duke e cilësuar mbylljen e institucioneve si një akt “terrori”, “epokë nacionaliste-fashiste” dhe

⁵ <https://demokracia.com/shba-ja-ndalon-perkohesisht-financimin-per-gjykatën-speciale-ne-hagë-cilat-jane-pasoja/> dhe <https://albanianpost.com/shba-ja-ndalon-perkohesisht-financimin-per-gjykatën-speciale-ne-hagë-cilat-jane-pasoja/> dhe <https://gazetainfokus.com/shba-ja-ndalon-perkohesisht-financimin-per-gjykatën-speciale-ne-hagë-cilat-jane-pasoja/>

⁶ <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/drecun-dokle-god-ima-srba-na-kosovu-kurti-ce-sprovoditi-terror-16-1-2025> dhe <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/vucevic-glasna-tisina-medjunarodne-zajednice-dok-pristina-nastavlja-zatvaranje> dhe <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/ogjenovic-medjunarodna-zajednica-konacno-da-reaguje-na-kurtijev-terror-15-1-2025> dhe <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/vucic-ocijedan-terror-kurtija-i-cudno-ponasanje-euleksa-srbi-nece-ostati-bez> dhe <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/andjelkovic-kurti-sprovodi-histericnu-kampanju-protiv-srba-na-kosovu-na-koju-niko-ne>

një përpjekje për të dëbuar serbët. Fjalët si “terror”, “fushatë hysterike” dhe “detyrim i serbëve për t’u larguar” krijojnë një narrativë shumë emocionale dhe alarmante. Ndërsa ndikimi në komunitetin serb është padyshim serioz, një gjuhë e tillë mund të përforcojë frikën dhe tensionin.

Në janar, zhvillimet në Kosovë morën mbulim të kufizuar në mediat në gjuhën serbe për shkak të trazirave të brendshme të shkaktuara nga protestat masive të studentëve kundër korrupsionit. Megjithatë, dy artikuj u shfaqën që përmbanin gjuhë veçanërisht ofenduese ndaj shqiptarëve, si dhe disa pjesë me integritet të dyshimtë të informacionit, veçanërisht në lidhje me mbylljen e institucioneve të menaxhuara nga Serbia dhe fushatën zgjedhore në Kosovë.⁷

Një artikull me titull “Mediat shqiptare (siptar) përhapin gënjeshtër! Tani është e qartë kush po orkestron kaosin në Serbi: Në Prishtinë, festojnë ‘rënien e Vuçiqit’!”, pretendon në mënyrë të rreme se ekstremistët shqiptarë të udhëhequr nga Albin Kurti po orkestrojnë trazira dhe kaos në Serbi. Artikulli më tej pohon se Kurti mbështet “opozitën e NATO-s në Serbi” dhe përfundon duke akuzuar mediat shqiptare për përhapjen e raporteve të rreme për “rënien e Vuçiqit”.

Në mbulimin e mbylljes së institucioneve të drejtuara nga Serbia, dominuan deklaratat e zyrtarëve serbë. Një artikull i tillë citon Aleksandar Vulin, një politikan serb, i cili nxiti tensionet duke thënë: “Qëllimi i të gjithë atyre që bombarduan Serbinë është spastrimi i serbëve në Kosovë dhe Metohi”. Vulin akuzon BE-në dhe SHBA-të se mbështesin veprimet e Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, kundër serbëve në Kosovë, ndërsa sugjeron se qëllimi i vërtetë i atyre që bombarduan Serbinë në vitin 1999 ishte pastrimi etnik i Kosovës dhe detyrimi i Serbisë që të pranonte pasojat e bombardimeve dhe dëbimit të serbëve. Ai gjithashtu pyet se pse Kurti nuk po përballlet me sanksione nëse veprimet e tij bien ndesh me interesat e SHBA-ve dhe BE-së.

Këta artikuj kanë mungesë të integritetit të informacionit dhe karakterizohen nga gjuhë nxitëse, pretendime të paverifikuara dhe manipulime emocionale. Ata paraqesin opinionet dhe supozimet si fakte, duke përdorur një kornizë të njëanshme për të promovuar një narrativë të caktuar.

⁷ <https://www.kurir.rs/vesti/politika/9559811/vulin-o-novom-talasu-terora-koji-kurti-sprovodi-nad-nasim-narodom> dhe <https://www.novosti.rs/vesti/politika/1450325/rasic-slavio-gracanici-sto-njegov-gazda-kurti-zatvori-ovu-srpsku-opstinu-video> dhe <https://informer.rs/sport/tenis/982040/australian-open-srbija-kosovo-navijaci> dhe <https://informer.rs/politika/vesti/984810/vucic-kurti-albanski-mediji>

The page features abstract geometric shapes in orange and purple. In the top-left corner, there are overlapping triangles of these colors. On the right side, there are larger, more complex orange shapes. At the bottom, there are purple shapes, including a large triangle on the left and a vertical rectangle on the right.

Ky raport është përgatitur nga Iniciativa e Re Sociale, një organizatë e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut për të ndikuar përfundimisht në gjithëpërfshirjen, ndërtimin e besimit, proceset e demokratizimit dhe qeverisjen e mirë në Kosovë. Duke vepruar kështu, NSI ndjek vizionin e saj për një shoqëri gjithëpërfshirëse të ndërtuar mbi besimin dhe vlerësimin midis komuniteteve të saj, në të cilën qytetarët nga të gjitha grupet etnike marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe në qeverisjen e saj.